



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr.73 dt.05.06.1998

MIRATIM FONDI PER DHENIE NDIHME FAMILJEVE KOSOVARE

Këshilli i Bashkisë Tiranë, i mbledhur sot me dt.05.06.1998, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Financës “Për miratimin e fondit për ndihmë familjeve kosovare nga të ardhurat e Bashkisë”, mbështetur në ligjin Nr.7776, dt.22.12.1993 “Për buxhetin lokal” dhe akteve të tjera nënligjore në zbatim të tyre

V E N D O S I

1. Të miratoj fondin prej **10.000.000 lekë** nga të ardhurat e Bashkisë të vitit 1998 për dhënie ndihmë familjeve kosovare.
2. Ti kërkohet Këshillit të Ministrave miratim i përdorimit të këtij fondi me anë të prokurimit të drejtëpërdrejtë.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme Organizim Personel e Shërbimeve dhe Drejtoria e Financës.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

ORHAN SAKIQI